REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5949/1 **Prot.** **Lushnje më,** 14/07/**2025**

PROJEKT - VENDIM
Nr 62 **Datë** 14/07/**2025**

" PËR NJË NDRYSHIM TË VKB-SË NR.70 DATË 04.09.2023 DHE MIRATIMIN E SIPËRFAQES SË SHESHIT TË NDËRTIMIT TË KORRIGJUAR TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVESISJES VENDORE"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2025 sipas relacionit të paraqitur në mbështetje të *nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2gërma"a"dhe"c",pika 1.6 gërma "a",neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*,Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2,pika 4,pika 6,gërma"a"pika 9.1,VKM nr.89 datë 13.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,paragrafi II rregjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik,të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent,si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj"si edhe nenit 193/b të Kodit Civil **JU**

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1 shkronja"F" të VKB-së nr.70,datë 04.09.2023.
2. Miratimin e sipërfaqes së sheshit të ndërtimit 106.5 m2 të ndodhur në ZK.8572 Lushnje për rregjistrimin e truallit në ASHK Lushnje sipas Plan rilevimit datë 25.06.202 pwr shtetasin Agim Guçi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE,PROKURORIMEVE DHE ASETEVE

Nr.5949 Prot.

Lushnje më, 14/07/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

" PËR NJË NDRYSHIM TË VKB-SË NR.70 DATË 04.09.2023 DHE MIRATIMIN E SIPËRFAQES SË SHESHIT TË NDËRTIMIT TË KORRIGJUAR TË DHËNË PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVESISJES VENDORE"

Të nderuar këshilltare/këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkise Lushnje, është paraqitur kërkesa e Z.Agim Guçi për të përfunduar procedurën e rregjistrimit të truallit të dhënë për ndërtim nga njësia vendore e cila ka mbetur pa u regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjensisë Shtetrore të Kadastrës"ASHK"Lushnje

Këshilli Bashkiak Lushnje mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga Bashkia, Vendimin e KRRT-së nr.5 datë 10.08.2000 me objekt "Shtëpi banimi 3 kt në lagjen "Skënder Libohova", me sipërfaqe sheshi ndërtimit 200 m2,Vërteti nit nr.64 datë 22.02.2001 nga Zyra e Urbanistikës Lushnje, me kufizime të pronës. në veri rugë kryesore, në jug Shkolla e mesme "18 Tetori" në lindje rrugë, në perëndim prona e vet prona it. Të planit të rilevimit datë 12.07.2023. Satusit juridik të dhënë nga DVASHK Lushnje datë 25.8. 023 është marr Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr.70 datë 04.09.2023 për rregjistrimin e truallit të dhënë për ndërtim. Qytetari Agim Guçi me marrjen e vendimit të Këshilit Bashkiak ka aplikuar për rregjistrimin e trualllit të dhënë për ndërtim. Ky aplikim nuk është rregjistruar pranë DVASHK Lushnje pavarësisht se kjo zyrë ka konfirmuar statusin juridik të kësaj prone sipas kërkesave ligjore. Pengesa ligjore e mosrregjistrimit të vendimit është bërë fakti se në gjurmën e dhenë për shesh ndërtimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Lushnje ndodhet gjurma e një vend strehimi.

Nisur nga ky fakt kërkuesi ka aplikuar në Bashkinë Lushnje me formular aplikimi nr.5507 datë 30.06.2025 për korrigjim të plan rilevimit.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

. Plan rilevimi datë 25.06.2025 i doërzuar në Bashki nuk ka përfshirë gjurmën e vendodhjes s vend strehimit me sipërfaqe 25.5 m2. Këshilli Bashkiak Lushnje në vendimin nr.70 ka miratua dokumentacionin sipas dosjes me sipërfaqe sheshit të ndërtimit për 130 m2 për shtetasin Agim Guci. Mbështetur në kërkesën e tij nr.5507 datë 30.06.2025 plan rilevimit të sjellë. me ndryshmet e kërkuara kjo sipërfaqe e sheshit të ndërtimi për tu miratuar me dokumentacionin e paraqitur është me sipërfaqe 106.5 m2.

Faleminderit për mirëkuptimin !

DREJTORIA JURIDIKE
BEDRI HIDA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com